

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Anketa e BB: Korrupsioni, pengesa kryesore për reformat në Shqipëri, problem edhe për biznesin... - Re aliteti Post
ADRESA	https://realitetipost.net/anketa-e-bb-korrupsioni-pengesa-kryesore-per-reformat-ne-shqip-eri-problem-edhe-per-biznesin/
BURIMI	realitetipost.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 15:56:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	2 shtator 2026, 11:43:52 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fd095361b746aa1f36d23ac87f065371af6fe29ca57b58d727b4a71ad8f04001
TEKSTI	0f0afa6fb68c825b42e54902c52723f17aebbb13de9803c26709aaaa67815173a
PAMJA	fdaf39de3c8d481e133582d748fafa9e086170327c28b575b379819cd3978f4c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b11d3af3ae35935a1a02fec9d4c88c6a830a23adc55078beca9ee53a350af62c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	bb4e79b3ec69077edf87697d0c7be1f8024ce2653cdf443ef98b2b2b16c0a234
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47169057
TRANSAKSIONI	0xc53d1d83eb5113e27101883e7ec1c599aedef807da486e98a6185fca192c6367
IPFS	QmVM2yPqkGdMM4oCMYr6dnZ3RqmeCHegWHRJZJGnzkgCiv



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b11d3af3ae35935a1a02fec9d4c88c6a830a23adc55078beca9ee53a350af62c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Anketa e BB: Korrupsioni, pengesa kryesore për reformat në Shqipëri, problem edhe për biznesin...

🕒 2 SHTATOR, 2026 · 📁 EKONOMI



Shpërndaje



Korrupsioni mbetet pengesa kryesore që ngadalëson ose pengon reformat ekonomike dhe sociale në Shqipëri, ndërsa për zhvillimin e sektorit privat, krahas korrupsionit, shqetësimi më i madh është mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar.

Kjo është një nga gjetjet kryesore të raportit "FY 2026 Albania Country Opinion Survey Report", të publikuar së fundmi nga Banka Botërore, i cili sjell perceptimet e aktorëve të ndryshëm në Shqipëri mbi sfidat e zhvillimit dhe rolin e Grupit të Bankës Botërore në vend. Anketa përfshiu 219 përfaqësues të institucioneve, biznesit dhe shoqërisë civile, të cilët u pyetën në pranverë të këtij viti.

Sipas anketës, 56% e të pyeturve e rendisin korrupsionin ndër faktorët kryesorë që bëjnë që reformat ekonomike dhe sociale në Shqipëri të dështojnë ose të ecin ngadalë. Diferenca me pengesat e tjera është e konsiderueshme.



Në vend të dytë renditet kapaciteti i pamjaftueshëm i qeverisë, i përmendur nga 35% e të anketuarve, ndërsa 34% e të anketuarve e shprehin problem mungesën e llogaridhënies së qeverisë dhe 33% presionet dhe pengesat politike.

Më tej, 26% e të anketuarve e lidhin ngadalësimin e reformave me pjesëmarrjen e pamjaftueshme të qytetarëve dhe shoqërisë civile, ndërsa 25% vlerësojnë se reformat nuk janë menduar siç duhet në raport me problemet konkrete të vendit.

Mungesa e punonjësve të kualifikuar dhe korrupsioni, problemet kryesore të biznesit

Të Fundit



HISTORI

Hafiz Mustafa Varoshi, martiri i Durrësit që u torturua dhe iu shkul mjekra nga regjimi komunist...



KULTURE

Shkodra Art Residency, artistë nga Shqipëria dhe bota krijojnë në qytetin e artit...



SPORT

Vllaznia dhe Jasmin Çeliković ndajnë rrugët...

BOTA | KRONIKE

Gaza mban funeralin e 100 palestinezëve të nxjerrë nga rrënojat e shtëpive të shkatërruara...

Rezultatet tregojnë se korrupsioni nuk shihet vetëm si pengesë për reformat, por edhe si një nga problemet kryesore për zhvillimin e sektorit privat. Kur janë pyetur për sfidat më të mëdha që përballojnë bizneset në Shqipëri, 52% e të anketuarve kanë evidentuar mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar dhe po 52% korrupsionin.

Problemi i tretë më i përmendur është mjedisi rregullator, me 47%, ndërsa 39% evidentojnë vështirësitë në aksesin në financim. Madhësia e tregut dhe kërkesa përbëjnë problem sipas 29% të të anketuarve, ndërsa 19% përmendin paqëndrueshmërinë politike dhe 18% mangësitë në infrastrukturë, përfshirë energjinë dhe transportin.

Gjetjet evidentojnë probleme institucionale, të lidhura me korrupsionin dhe një kufizim gjithnjë e më i madh nga kapitali njerëzor, teksa bizneset kanë vështirësi të gjejnë punonjës me aftësitë e kërkuara.

Bujqësia dhe arsimi shihen si prioritetet kryesore të zhvillimit

Anketa e Bankës Botërore ka pyetur gjithashtu aktorët se në cilat fusha duhet të përqendrohet institucioni për të pasur ndikimin më të madh në zhvillimin e Shqipërisë.

Bujqësia dhe siguria ushqimore renditen të parat, të përzgjedhura nga 49% e të anketuarve, të ndjekura shumë pranë nga arsimi, me 47%.

Shëndetësia është prioritet për 36% të të pyeturve, vendet e punës për 34% dhe zhvillimi i infrastrukturës digjitale për 32%. infrastruktura e transportit dhe menaxhimi i mjedisit dhe burimeve natyrore marrin nga 29%, ndërsa zhvillimi i sektorit privat përzgjidhet nga 28%.

Turizmi shihet me potencialin më të madh për vende të reja pune

Një tjetër gjetje e anketës lidhet me sektorët që kanë potencialin më të madh për të gjeneruar punësim. Turizmi është sektori më i përmendur për krijimin e vendeve të reja të punës, por të anketuarit theksojnë nevojën për të reduktuar varësinë nga turizmi masiv i verës dhe për ta diversifikuar ofertën drejt agroturizmit, turizmit kulturor, historik dhe atij të aventurës, në mënyrë që sektori të sigurojë punësim gjatë gjithë vitit.

Pas turizmit renditen bujqësia dhe agro-përpunimi, me fokus te aktivitetet me vlerë të shtuar, si përpunimi, eksportet organike, magazinimi frigoriferik dhe paketimi. Teknologjia e informacionit dhe shërbimet dixhitale konsiderohen gjithashtu sektorë me potencial për punësim të kualifikuar dhe rritje të orientuar drejt eksporteve.

Energjia e rinovueshme, infrastruktura e gjelbër, ndërtimi, infrastruktura dhe industria e lehtë përmenden gjithashtu si fusha që mund të krijojnë vende pune, veçanërisht jashtë Tiranës.

Reformat mbeten teorike

Anketa tregoi se një nga kërkesat më të shpeshta ndaj Bankës Botërore ishte që të fokusohet më shumë te zbatimi dhe rezultatet e matshme, pasi të anketuarit e shohin hendekun kryesor jo te projektimi i politikave, por te kthimi i reformave në rezultate konkrete.

Të anketuarit kërkojnë gjithashtu forcimin e kapaciteteve institucionale dhe njerëzore, më shumë asistencë teknike afatgjatë dhe angazhim më të gjerë me sektorin privat, pushtetin vendor, shoqërinë civile dhe universitetet.


Raporti rekomandon, mbi bazën e këtyre përgjigjeve, që financimi të lidhet më shumë me tregues të matshëm, si përmirësimi i shërbimeve, reduktimi i kohës së procedurave dhe krijimi i vendeve të punës./ B.Hoxha/monitor

BOTA

Dënohen thirrjet e ministrave izraelitë për të zhvendosur palestinezët nga Gaza

HISTORI

Hoxhallarë dhe personalitete myslimane të përndjekur, burgosur dhe ekzekutuar gjatë regjimit komunist...



Shpërndaje



Të Ngjashme

Bashkitë mbledhin dyfishin e taksave nga qytetarët – 430 milionë euro në 7 muaj, më shumë para' edhe nga pronat...

3 Shtator, 2026

Elon Musk i pandalshëm, kush janë 10 njerëzit më të pasur në planet (LISTA)...

2 Shtator, 2026

Shqipëria, mbi dyfishin e BE-së për peshën e ushqimeve në shpenzimet e familjeve...

2 Shtator, 2026



KRYESORE

Aktualitet

Kronikë

Politike

Ekonomi

Bota

TË TJERA

Sport

Kulturë

Sociale

Arsim

Teknologji

Copyright © 2026 - Realiteti Post

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.